



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2869/2 prot.,

Datë 28.12.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRIPTIK” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-51250-11-24-2022, me objekt: “Shërbim printim dhe zarfim të faturave”, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër.

**Ankimues:** “INPRESS” SHPK  
*Adresa: Ish-Blloku i Magazinave të Tregëtisë, rruga ‘Siri Kodra’, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër  
*Adresa: Gjirokastër*

Në datën 27.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2869 prot., e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-51250-11-24-2022, me objekt: “Shërbim printim dhe zarfim të faturave”, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për pranimin e ankesës nr. 75 prot, datë 19.12.2022 të operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK, si dhe me kundërshtimin

e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TRIPTIK” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK përsa i përket vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me ankesën nr. 75 prot, datë 19.12.2022 të operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK, si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik “INPRESS” SHPK, në ankesën me nr. 2869 prot., datë 27.12.2022, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “TRIPTIK” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime përsa i përket vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me ankesën nr. 75 prot, datë 19.12.2022 të operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK, si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik “TRIPTIK” SHPK ka paraqitur ankesë nr. 75 prot, datë 19.12.2022 pranë autoritetit kontraktor jashtë afatit të përcaktuar ne nenin 110, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik’.*

*Autoriteti kontraktor në kundërshtim me dispozitat e nenit 110, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik’ në vend që të refuzonte/mospranonte proceduralisht ankesën e operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK, pasi ishte paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në LPP, në mënyrë të çuditshme ka shqyrtuar përmbajtjen e ankesës dhe e ka pranuar plotësisht atë. Së treti në lidhje me këtë aspect dhe çështje Komisioni i Prokurimit Publik ka pasur rastin të shprehet disa herë me anë të vendimeve të tij.*

*Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik mbi këtë çështje është shprehur edhe me vendimin e tij (interpretues) nr. 305/2021, datë 23.06.2021, ku qartësisht ka interpretuar afatet kohore për paraqitjen e ankesave nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar, bazuar në LPP dhe rregullat e prokurimit public.*

*Për të gjitha sa parashtruar më sipër, përsa i përket aspektit procedural, Komisioni i Prokurimit Publik do të duhet të:*

*- Ndryshojë vendimin e marrë nga AK Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SH.A për rivlerësimin e ofertave, bazuar në ankesën e operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK.*

*- Skualifikojë operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK, si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK.”*

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

*“Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK në lidhje me skualifikimin e këtij operatori ekonomik nga KVO e AK: “Pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga OE , rezulton se formulari ofertës shtojca 1 janë të plotesuara me të dhëna të tjera dhe jo të procedurës në të cilën operatori ekonomik është pjesëmarrës dhe formulari sigurimit të ofertës ka të dhëna gabim. Dokumentat e firmosura dhe vulosura nga administrator janë me vulë dhe firmë të paqartë Bazuar ne LPP nr.162 dhe VKM nr.285, date 19.05.2021 e ndryshuar oferta është e pavlefshme.”, sqarojmë se operatori ekonomik i interesuar “INPRESS” SHPK është plotësisht dakort me vendimmarrjen dhe arsyetimin e KVO e AK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “TRIPTIK” SHPK, për mospërmbushje të këtij kriteri kualifikues të përcaktuar në DST dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës, aktualisht në fuqi. Rrjedhimisht në zbatim të legjislacionit shqipëtar aktualisht në fuqi, operatori ekonomik “TRIPTIK” SHPK do të duhet të rezultojë i skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve teknike të përcaktuara në DST, sipas arsyetimit të parashtruar nga KVO e AK.*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- **2.1.2 Ofertuesi duhet të paraqesë nje vertetim qe** ka paguar detyrimet e ujit te pijshem dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- **Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 9.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i çertifikuar sipas Standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- ISO 9001 : 2015 “Për sistemin e menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente (e vlefshme).
- ISO 27001 : 2018 “Për Sigurinë e Informacionit” ose ekuivalente (e vlefshme).”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 28.12.2022.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**